



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neni 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe neni 56 shkronja b) të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga ana e Komisionit, të përzgjedhjes së OJQ-ve dhe Klubeve sportive për financim publik të programeve/projekteve në fushën e aktiviteteve kulturore, rinore dhe aktiviteteve sportive, sipas Thirrjes publike të dt. 04.04.2018, merr:

### **VENDIM**

### **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE ORGANIZATAT JO-QEVERITARE-OJQ DHE KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

#### **Neni 1**

Për financim publik të organizatave jo-qeveritare OJQ-të dhe Klubeve sportive për realizimin e programeve/projekteve në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore si dhe aktiviteteve sportive, sipas Thirrjes publike të dt. 04.04.2018, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme 21,950 €.

#### **Neni 2**

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të projekteve si dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

#### **Neni 3**

Listat përfundimtare e përfituesve të mbështetjes financiare janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

#### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

**Nr. 02-400/03-0040941/18**  
**Podujevë, dt. 21 maj 2018**

**Kryetari i Komunës**  
**Agim Veliu**